

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë
Gostivar viti 2018 - 2019

SHKOLLA FILLORE "ÇAJLA" - FSH ÇAJLË - GOSTIVAR



Fsh. Çajlë - Gostivar tel/faks
042-287-147
e-mail:infocajla@gmail.com

***Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë
Gostivar viti 2018 - 2019***

Tetor,2019

Raport nga realizimi i vetevalimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019

RAPORT

Për realizimin e vetevalimit për periudhën 2019-2021 me propozim masa për përmirësimin e punës së shkollës.

Në bazë të nenit 129 alinea 1 nga ligji për arsim fillor ("Gazeta zyrtare e R.M nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010,156/2010,18/2011,51/2011, 06/2012, 100/12,24/13, 41/14, 116/14,135/14, 10/16, 98/15,145/15,30/16, 127/16, 67/17 dhe 161/19) dhe vendimit të këshillit të shkollës "Çajla" fshati Çajlë dhe formimit të komisioni shkollor pregaditë raport për realizimin e vetevalimit në periudhën 2019-2021 me propozim masa për përmirësimin e punës së shkollës.

Komisioni në përbërje	
1.Qefsere Velija	Hane Elezi- prind
2.Melihat Fejzuli -Psikolog	Gjylneare Miftari - Arsimitar
3.Ekrem Ismaili - Arsimitar	

QËLLIMET NGA REALIZIMI I VETEVVALIMIT:

- Qëllimi i evaulimit përfaqëson modifikim, perfeksionizim dhe avansim të praktikës
- Evaulimi përfaqëson bazë për intervenim, aksion, pra plan aksional dhe programe zhvillimore
- Njohuritë që do ti arrijmë nga evaulimi, luajnë rolin e korrektorit për planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të mëtutjeshme.

Vetevalimi në shkollën tonë bazohet në bazë të konceptit *Vetevalimi sipas nevojave të fëmijës* dhe ka për qëllim të mundësojë qasje në gjendjen e shkollës në marrëdhënie në gjashtë dimensionet e projektit (VNF) të cilët janë (inkluzioni, efektiviteti, shëndetësia dhe siguria, gjithëpërfshirja gjinore, participimi i nxënësve, prindërit dhe shoqëria dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve, multikulturalizmi). Nga prespektiva e arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve në vetevalimin shihet si mjet që mundëson që shkolla të zhvillojë strategji për realizimin e projektit UNF, standardet nga të cilët me pjesëmarrje aktive të arsimtarëve, prindërve dhe nxënësve gjatë gjithë proesit, prej identifikimit të gjendjes deri te krijimi i planeve për përmisimin e gjendjes.

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019

Rezultatet e pritura

Realizimi i vetevaulimit gjithmonë do të rezultojë bashkimin e iniciatorëve nga vetvlerësimi i kualitetit, me mundësinë për avansimin e kualitetit të arsimit në vetë shkollën.

- Vetevaulimi e ngrit dialogun pedagogjiko-psikologjik në mes kolegëve për rëndësinë për përmirësimin e kualitetit edukativo-arsimor.
- Të dhënat do ti ndihmojnë shkollës të kryejë vetëanalizë të vetëveprimit dhe me të vlerëson përparësitë e veta para tjerëve dhe mangësitë për ndërtimin e punës ekipore dhe procesit arsimor.
- Vetevaulimi e ngritën motivimin tek arsimtarët dhe nxënësit.

Kush do të ketë favore (fitime) nga vetevaulimi?

- Nxënësit do të kenë arsim kualitativ, komunikim dhe motivim më të mirë në procesin arsimor.
- Arsimtarët e rrisin dhe avansojnë autonominë metodiko-didaktike në plan profesional dhe organizativ, zhvillojnë mundësinë për nxitje të punës së vet kualitative në shkollë
- Shkolla nga e gjithë njohja e komponentave të sistemit për mësim të përjetshëm, vetë i klasifikon anët pozitive dhe negative nga marrja e analizave nga vetevaulimi dhe me këtë krijon zhvillim të kualitetit të procesit arsimor.
- Shoqëria më e gjërë fiton nga kualiteti i arsimit në shkollë. Me këtë individ të ndryshëm që dalin nga kjo shkollë, aftësitë e veta i shprehin në sektor të ndryshëm si në ato shërbyese dhe degët tjera në të mirë të shoqërisë ku jetojnë

Vetevaulimi në sistemin e mësimin të përjetshëm është një gjenerator emotiv i ndërgjegjes kolektive dhe individuale për ndryshim të vetes si dhe avansimin e punës arsimore për afrimin ndaj nevojave të nxënësve

Sistemi i vetevaulimit është i ndërtuar duke respektuar këto principe:

- **Relevancë**- lëndë e evaulimit me fusha më të rëndësishme dhe aspekte të procesit arsimor, aspekte të rëndësishme të standardeve të pranura arsimore të përkthyer në indikatorë operacional dhe të njohur për kualitet.
- **Shfrytëzues** - esenca e evaulimit është e shfrytëzueshme, nga ajo dalin informata që ndihmojnë në planifikimin dhe inovacionin e aksioneve tjera që janë në funksion të avansimit dhe ruajtjes së kualitetit të arsimit, të mësuarit dhe rezultatet e nxënies.
- **Realizatorë** - qëllimi i evaulimit është real në lëndën, kushtet, mjetet, kohën dhe kuadrin
- **Vlerëshmëri** - evaulimi mundëson njohje nga ajo që njihet si objektive, e fshehur dhe mënyrë e qartë e përdorshme.
- **Transparencë** - përmban programe, kërkesë për nivel programor, standarde arsimore dhe kriteriume për vlerësim, nota që duhet të jenë të qarta dhe të njohura nga evulatori, dhe nga ai që puna e tij evulon me aktorët tjerë të interesuar për sitemin arsimor.
- **Profesionalizëm** - aspektet organizative, metodike dhe teknike të evaulimit janë në nivel të

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019


standardeve profesionale bashkëkohore dhe kjo nënkupton aftësinë plotësuese të planifikimit dhe realizimit të evaulimit dhe vetevaulimit.

- **Përkohshmëri** - proceset kohore ku kryhen aktivitet evaulative dhe informacionet kthyese për rezultatet e evaulimit janë ashtu të planifikuara që të mund të ketë interes ai që evaulohet dhe ai që e ka planifikuar evaulimin nga informacionet kthyese që fitohen, gjegjësisht të kenë kohë të marrin masat e duhura korektive dhe të sjellin vendimet e duhura .
- **Disponueshmëri** - informatat e grumbulluara në procesin e evaulimit në forma të përdorshme të jenë të kumtuara atij për të cilin janë të dedikuara.
- **Participim** - përherë në vetevaulim marrin pjesë të dy anët edhe atë: drejtori dhe të punësuarit.
- **Vullnetarizëm** - vlen për të gjitha format e evaulimit të cilët me ligj nuk janë të lejuara.

Lëndët e vetevaulimit janë tetë fusha kryesore jetike që vlejné në aspektet kryesore të punës së shkollës të secilën fushë ku punonte grupi i arsimtarëve.

Fushat	Grupet punuese
Planprogramet mësimore	Merita Mustafa,Ajten Useini,Etem Aliu.Valbona Jashari-arsimtarë. /Merita Xhabir-prind/ Endrit Memedi-nxënës
Të arriturat e nxënësve	Ekrem Ismaili,Ruhide Ismaili,Herolinda Zeqiri,Luljeta Aliu-arsimtar Hana Elezi - prind/ Altin Elezi - nxënës
Të mësuarit dhe mësimi	Rukije Musliu, Lavdrime Fazlija, Narta Murati, Fatbardha Useini - arsimtarë/ Dashurije I.Elezi- prind/ Sare Miftari - nxënës
Përkrahja e nxënësve	Sali Jonuzi, Ardita Sinani, Xhevahir Jashari, Shinazi Elezi - arsimtarë/ Lirije Emini - prind/ Ensar Elezi - nxënës
ETOS - klima në shkollë	Taner Sagiri, Valbona Jashari, Gjulneare Miftari, Xhumaliqe Durmishi - arsimtarë/ Qefsere Velija - prind/ Eda Durmishi - nxënës
Resurset	Ajshe Aliu, Luljeta Aliu, Enise Tairi, Mirlinda Jashari - arsimtarë/ Jetmir Murtezani - prind/ Omer Musliu - nxënës
Udhëheqja dhe krijimi i politikave	Enisa Tairi, Mevlude S. Medija, Zylejha A. Nuredini, Lirije Emini - arsimtarë/ Mevlude Medija - prind/ Lirzana Selmani - nxënës
Integrimi ndëretnik dhe zgjidhja e konflikteve	Ekrem Ismaili, Rukije Musliu, Etem Aliu, Qefsere Velija - arsimtarë/ Fatlume Hajdari - prind/ Zerina Hajdari - nxënës

Përmirësimi i punës në shkollë, sigurimi i kualitetit në arsim.



Në secilën fushë grupa e arsimtarëve punonte prej së pari pregaditur indikatorë që masin kualitetin e punës së shkollës, ndërsa si burim të të dhënave u shfrytëzuan intervista, pyetësor për nxënës, prindër dhe arsimtar, qasje në dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike, analiza në dokumente, biseda etj. Vetevaulimi u realizua në periudhë Tetor - Nëntor 2019. Gjatë vetevaulimit u shfrytëzua dhe doracaku i vetevaulimit sipas nevojave të fëmijëve, vetevaulimi si faktor për evulim të suksesshëm integral të shkollës si dhe doracaku si pjesë e projektit për integrim ndëretnik në arsim.

1. Planprogramet arsimore

Shkolla planifikon dhe realizon forma të ndryshme të arsimit - obligueshme, plotësuese, shtuese, aktivitet e lira dhe aktivitet jashtëarsimore. Planprogramet arsimore janë realizuar në pëlqim të MASH- it dhe BZHA-së dhe realizohen sipas formës së përshkruar. Arsimtarët gjatë planifikimit të mësimit gjithmonë bashkëpunojë me aktivin profesional. Shkolla shfrytëzon mënyra të ndryshme që ti informojë prindërit për punën e vet si dhe të njejtit ti përfshijë në të. Shkolla u mundëson nxënësve të përfshihen në aktivitet jashtëmësimore të varura nga dëshira e tyre dhe mundësia në mënyrë aktive të marrin pjesë në pregaditjen e programit për aktivitete jashtëmësimore ku arsimtarët e luajnë rolin këshillues dhe koordinues

Në bazë të analizës së kryer për këtë fushë vlen:

Anët e forta jetike.

- Realizimi i planprogrameve mësimore janë në përputhshmëri nga dokumentet programore të sjella nga MASH dhe BZHA.
- Planprogramet mësimore janë të përshtatur sipas mundësisë dhe rrethit nga ku vijnë nxënësit.
- Puna ekipore

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019

- **Shkolla ofron më shumë se 3 lëndë zgjedhore.**
- Edukim permanent i kuadrit arsimor.
- Qasje për të gjithë në teknologjinë informative.
- Puna e shkollës është publike. Të gjithë të interesuarit kanë mundësi të njihen me aktivitetet e shkollës dhe ndërmjet institucioneve të saj të ndikojë në realizimin e ë njejtëve.
- Në shkollë veçanërisht mbahet llogari për të drejtat e fëmijëve dhe kyçjen aktive në jetën dhe punën e shkollës.
- Aktivitetet jashtëmësimore kanë vend të veçantë në procesin edukativo-arsimor, ku mbahet llogari të marrin pjesë të gjithë nxënësit sipas afiniteteve dhe mundësive të veçanta.
- Organizmi i seminarëve dhe trajnimeve të ndryshme si dhe pregaditja metodiko-didaktike e kuadrit arsimor për arsim bashkëkohor nga MASH dhe BZHA si dhe nga organizatorë të tjerë të interesuar për zhvillimin e arsimit.

Dobësitë

- Nevoja e kompetencave më të mëdha të arsimtarëve për punë më nxënës të talentuar.
- Mospasja e mjeteve mësimore për punë më nxënës të talentuar
- Modernizimi i planprogrameve mësimore nga ana e BZHA -së.
- Numër i vogël i literaturës dhe revistave shkencore.
- Mospasja e hapsirës funksionale të mbyllur për prezentim të rezultateve nga aktivitetet jashtëmësimore

Mundësitë:

- Gjetja e medimeve të ndryshme për informim të shoqërisë më të gjërë për qëllimet e planprogrameve mësimore që realizohen.
- Përkrahja nga biznes sektori lokal për nxënësit e talentuar.

Rreziqet

- Vëllimi dhe ngarkesa nga planprogramet mësimore

Aktivitetet e ardhëshme nga kjo fushë që mund të përfshihen në prgramin për zhvillim të shkollës

- Gjetja e mjeteve dhe mënyrave për pajisjen e shkollave me mjete mësimore.
- Puna ekipore për planifikimin vjetor në vertikale për të arritur integrim më të madh të lëndëve të ndryshme.
- Profesionalizim permanent i kuadrit arsimor me punë me nxënës të talentuar dhe nxënës me nevoja të veçanta.
- Bashkëpunim më i madh i arsimtarëve për pregaditjen e planifikimeve vjetore.
- Adaptimi i hapsirës funksionale për prezentim të aktiviteteve të shkollës

2. Të arriturat e nxënësve

Shkolla në mënyrë permanente ndjek të arriturat e nxënësve për dallim nga gjinia, statusi social

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019

ose etnik të familjes. Arsimitarët i motivojnë nxënësit dhe e stimulojnë punën e tyre, vetiniciativën dhe kreativitetin. Rezultatet e suksesit të arritur në këshillat e klasës krahasohen me periudhat e mëparshme. Kriteriumi i notimit është objektiv dhe publik, ndërsa notimi kryhet në mënyrë transparente duke u shpjeguar. Prindërit rregullisht dhe me kohë informohen për të arritur e nxënësve nëpërmjet mbledhjeve prindërore dhe e-ditarit.. Poashtu është konstatuar se në shkollën tonë kemi zvogëlim të numrit të nxënësve edhe atë duke emigruar me tërë familjet në shtetet Europiane.

Në bazë të analizës së kryer për këtë fushë vlen:

Anët e forta jetike

- Ndjekje në kontinuitet e të arriturave të nxënësve pa dallim gjinie, feje dhe etnike sipas lëndëve mësimore.
- Përmirësimi i të arriturave të nxënësve ndërmjet mësimin shtues dhe plotësues.
- Bashkëpunim i mirë ndërmjet arsimtarëve, drejtorit dhe shërbimit profesional dhe koordinimi i mirë mes tyre.
- Numër solid i nxënësve dhe rezultat i kënaqshëm i të arriturave të nxënësve afër notës shumë mirë (4)
- Mbulim i nxënësve në aktivitete jashtëmësimore të organizuar në seksione dhe grupe si dhe puna produktive nga këto seksione që si përfundim vjen deri te manifestimet në shkollë a më tepër ndërmjet garave shkollore, komunale dhe regjionale.
- Shpërblimi i nxënësve për arritje të rezultateve të kënaqshme në gara dhe konkurse.
- Përdorimi i kompjuterave dhe projektorëve për realizimin e mësimin interaktiv.
- Rezultatet e kënaqshme në pjesën e ekologjisë dhe sigurisë në komunikacion të nxënësve.
- Përmirësimi i suksesit si rezultat i mbledhjeve të **aktiveve profesionale**.
- Puna efektive me shërbimin profesional të shkollës.
- Për të arriturat e nxënësve prindërit rregullisht informohen nëpërmjet mbledhjeve prindërore dhe e-ditarit si dhe në bashkëpunim në relacion nxënës-prindër-shërbim profesional - drejtor.

Mundësitë:

- Përkrahja nga prindërit

Rreziqet:

- Bashkëpunimi i dobët me prindërit e nxënësve me sukses të dobët.
- Ngarkesa dhe volumi i madh i planprogrameve mësimore.

Dobësitë:

- Identifikimi i vonuar i punës me nxënës të talentuar.
- Bashkëpunim i dobët me prindërit e nxënësve me sukses të dobët.
- Mungesa e punës kabinetike
- Mungesa e mjeteve më didaktike më bashkëkohore.
- Notimi objektiv dhe transparent i të arriturave të nxënësve sidomos në raste në fund të vitit shkollor për përmirësimin e suksesit të nxënësve.

Aktivitetet e ardhshme nga kjo fushë që mund të kyçen në programin zhvillimorë të shkollës.

- Përmirësimi i bashkëpunimit me prindërit e nxënësve me sukses të dobët.
- Pajisja e procesit arsimor me mjete didaktike bashkëkohore.

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019

- Përdorimi i formave, metodave dhe teknikave bashkëkohore në procesin edukativo-arsimor.
- Vazhdimi i edukimit të kuadrit arsimor për përdorimin e mjeteve bashkëkohore e sidomos teknologjise informative në procesin edukativo-arsimor.
- Përdorimi i mënyrës formative dhe sumative për notimin e nxënësve
- Përkrahja dhe motivimi e nxënësve për zhvillimin e vetëdijes ekologjike.

3. Mësimdhënia dhe mësimi

Arsimtarët pregadisnin planifikime vjetore , tematike dhe procesuale në fillimi të vitit shkollor. Rregullisht realizojnë pregaditje ditore në formë elektronike dhe në fund të javës e dorëzojnë në shërbimin pedagogjiko-psikologjik.

Në planifikim janë të kyçura dhe metoda të ndryshme për notim,si dhe instrumentet në bazë të së cilëve kryhet notimi formativ dhe sumativ. Arsimtarët planifikojnë detyra dhe aktivitete që duhet të realizohen në shkollë dhe shtëpi, dhe të përshtatura në nevojat e nxënësve për ti realizuar qëllimet e caktuara të mësimi. Mënyra e mësimi në shkollë është interesant me motivim nga ana e arsimtarëve tek në më shumë nxënës të cilët do të marrin pjesë aktive në orë. Vlen të përmendet se përdorimi i teknologjisë informative është edhe një stimul plus për arritjen e standardave për notim si dhe formë për informim të prindërit për të arriturat e nxënësve në shkollë.

Në bazë të analizës së kryer për këtë fushë vlen:

Anët e forta jetike:

- Pregaditja në kohë i planifikimit global , tematik dhe procesual.
- Pjesëmarrja aktive e arsimtarëve në punë me nxënësit.
- Kyçja e sistemit për mbikqyrje të orës mësimore
- Prezentimi i punimeve të nxënësve nga shkolla
- Nxënësit grupohen në seksione dhe grupe sipas afiniteteve dhe dëshirave.
- Notimi i nxënësve është objektiv i transparent .
- Egziston punë ekipore tek arsimtarët.
- Prindërit rregullisht informohen për të arriturat e nxënësve

Mundësitë:

- Përkrahje nga prindërit

Rreziqet :

- Bashkëpunimi i dobët me prindërit e nxënësve me sukses të dobët.
- Vëllimi dhe ngarkesa e planprogrameve mësimore.

Dobësitë:

- Funksionimi i dobët i kompjuterëve nëpër klasa dhe rrjetit të teknologjisë informative.
- Mospasja e mësimi kabinetik ,përveç lëndës së arsimit muzikor dhe punës me kompjuter.
- Realizimi i formave dhe metodave bashkëkohore në mësim.
- Pregaditja e kabineteve për realizim të mësimi kabinetik.

Aktivitetet e kësaj fushe nuk mund të kyçen në programin zhvillimor të shkollës

4.Përkrahja e nxënësve

Është konstatuar se të gjithë subjektet të procesit edukativo-arsimor kontribuojnë për klimë

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019

pozitive për punën në shkollë.

Ata punojnë që të gjithë nxënësit të ndjehen të sigurtë dhe ajo është vërtetuar me marrjen dhe pjesëmarrjen në shumë aktivitete për shkollë të sigurtë ku edukohen dhe shkollohen dhe socializohen , prej ku vendoset themeli që do të marr pjesë për ngritjen dhe formimin e personave pozitiv të shoqërisë. Shkolla mban përgjegjësi për arsimimin e mëtutjeshëm të nxënësve , edhe atë me anë të bisedës , prezentimit të shkollave të ndryshme , broshurve etj.

Në bazë të analizës së kryer për këtë fushë vlen:

Anët jetike të shkollës

- Shkolla u jep përkrahje nxënësve pa dallim të gjinisë , fesë dhe statusit social.
- Arsimtarët çdo ditë mbajnë evidencë për rregullshmërinë, sjelljen dhe të arriturat e nxënësve në rregjistrat shkollor e ditarin dhe listat evidentuese.
- Prindërit rregullisht informohen për të arriturat e nxënësve.
- Orientimi profesional i nxënësve të klasave të nënta me kohë fillon , shihen dhe sqarohen konkurset e shpallura nga shkollat e mesme dhe me to kryhen biseda të ndryshme.
- Bashkëpunimi me shkollat e mesme të qytetit dhe më gjerë.
- Këshillim i rregullt me prindërit e nxënësve që tregojnë interes të dobët në mësim, kanë rezultate të dobëta dhe nuk e zbatojnë kodesin e shkollës.

Mundësitë:

- Përkrahje nga prindërit

Rreziqet:

- Bashkëpunimi i dobët me prindërit e nxënësve me sukses të dobët.
- Vëllimi dhe ngarkesa e madhe të planprogrameve mësimore.

Dobësitë:

- Interesimi jo i mjaftueshëm i prindërve për marrje të informatave nga shkolla për orientim profesional të fëmijëve të tyre.
- Bashkëpunim më i madh me shkollat e mesme në komunat tjera

Aktivitetet e ardhëshme nga kjo fushë të cilat mund të kyçen në programën për zhvillim të shkollës

- Përmirësimi i bashkëpunimit me shkollat e mesme me komunat tjera.
- Edukimi i prindërve për rolin e shkollës për zhvillimin e fëmijëve të tyre.

5.Klima në shkollë

Klima në shkollë është në nivelin më të lartë, ajo manifestohet me qasje të drejtë kundrejt të

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019

gjithë nxënësve, të punësuarve dhe prindërve. Kodekset, rregullat dhe normat e shkruara respektohen në përpikmëri. Për arritjen e kësaj klime pozitive, grupi udhëheqës dhe organet tjera kanë krijuar politikë për arritje pozitive. Puna ekipore dhe profesionale e kuadrit arsimor. Janë tipar e trekëndëshit pedagogjik (nxënës-arsimtar-prindër) si dhe bashkëpunimi me prefektin, vetqeverisja lokale, biznes sektori, MASH dhe BZHA.

Shërbimi profesional në bazë të realizimit të aktiviteteve programore kontribon që nxënësit të mësojnë të njohin dhe të ballafaqohen me situata konkrete në lidhje me diskriminimin në baza etnike, gjinore dhe sociale. Të arriturat dhe rezultatet e nxënësve, kontinuitet ndiqen dhe prezentohen në periudha të ndryshme gjatë vitit shkollor.

Shkolla nuk ka probleme në marrëdhënie me sjelljen dhe disiplinën e nxënësve. Rregullisht promovohen të arriturat e nxënësve, a me të, dhe promovimi i shkollës në nivel lokal dhe më gjerë. Notimi i suksesshëm në nivel të shkollës është vërtetuar me respektimin e kriteriumeve për notim formativ dhe sumativ.

Në bazë të analizës së kryer për këtë fushë vlen:

Anët të forta jetike

- Klimë pozitive për punë në shkollë.
- Bashkëpunimi në mes arsimtarëve dhe nxënësve bazohet në besim të ndërsjelltë dhe respekt.
- Rregullshmëria në mësim dhe sjellja shembullore.
- Motivimi i vazhdueshëm i nxënësve.
- Rezultatet e mira në gara.
- Klima e mirë në mes të punësuarve dhe nxënësve.
- Mënyra e funksionimit të ekipeve në shkollë.
- Përcjellja e punës së arsimtarëve, edukimi i tyre, profesionalizimi dhe zhvillimi permanent si dhe shpërblimet.
- Përkrahja reciproke dhe çiltërsia në bashkëpunim.
- Zgjedhja dhe preventiva në lidhje me disiplinën dhe sjelljen e nxënësve. Dhënia e mundësisë së njejtë e të gjithë nxënësve për mësim si dhe shpërblimi i diturisë.
- Mundësimi i njejtë për të gjithë nxënësit për pjesëmarrje në gara dhe konkurse.
- Të gjithë nxënësit, në kontinuitet dhe objektivisht të notuar.
- Mundësitë e njejtë për shfrytëzimin e teknologjisë informative.
- Zgjedhja e nxënësit më të mirë të klasës, dhe shpërblimi nga ana e biznes sektorit.
- Organizimi i manifestimeve dhe ekspozitave të artit
- Dhënia e diplomave për nxënësit e shkëlqyeshëm.
- Rrespektimi i të drejtave të nxënësve.
- Këshillimi i prindërve nga ana e psikologut.
- Ditë të hapura të shkollës për bashkëpunim me prindërit.
- Bashkëpunim me institucionet tjera (MASH, BZHA).

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019

Dobësitë:

- Bashkëpunimi i dobët i prindërve të nxënësve me sukses të dobët.
- Rrezistencë për ndryshime të numër i vogël i arsimtarëve.
- Domosdoshmëria e edukimit të arsimtarëve për punë me nxënës të talentuar.
- Vështirësitë që hasin arsimtarët që në paralelet e tyre ka nxënës me nevoja të veçanta.

Mundësitë:

- Partneritet me shkollat tjera.
- Zhgillimi i teknologjisë dhe inovacionit. Përkrahja nga shoqëria lokale.
- Trajnimi për punë me nxënës të talentuar
- Përmirësimi i kushteve për punë me nxënës me nevoja të veçanta

Rreziqet:

- Efektet nga rrethi
- Efektet nga ndryshimet arsimore
- Gjendja ekonomike

Aktivitetet e mundëshme nga kjo fushë që mund të kyçen në programën për zhvillim të shkollës.

- Promovimi i të arriturave të nxënësve në nivel lokal , regjional , shtetëror dhe ndërkombëtar
- Bashkëpunimi me prindërit e nxënësve që tregojnë sukses të dobët
- Bashkëpunimi me shkollat tjera që kanë përzierje etnike
- Formimi i ekipës për promovim dhe afirmim të shkollës
- Rregullimi i pamjes së jashtme të shkollës.
- Trajnimi i arsimtarëve për punë me nxënës të talentuar dhe inkluzion me nxënës me nevoja të posaçme.

6. Resurse

Mësimi realizohet në shkollë qendrore me infrastrukturë të rregulluar deri në objektin e shkollës. Hapësira shkollore është ashtu e organizuar që mësimi mund të realizohet pa pengesa. Shkolla mundohet ti përmirësoj kapacitetet hapsinore për të cilat kanë merita të punësuarit, të cilët në aksione të përbashkëta e kanë përmirësuar hapësirën shkollore. Shkolla bën përpjekje të jetë në kohë me të rejat në arsim dhe për këtë shkak çdo herë i përcjell dhe i porosit mjetet e reja didaktiko-metodike.

Kuadrit arsimor është profesionist , që është kusht për arsim kualitativ. Shkolla respekton rregullativën ligjore për zhvillim profesional të kuadrit dhe ka mekanizma të brendshme për dhënien e lëndave për arsimtarët e suksesshëm që fusin inovacione efektive në punë.

Shërbimi profesional me programën e saj planifikon dhe realizon aktivitete të ndryshme për punë me nxënësit dhe arsimtarët dhe është e hapur për ndihmë dhe bashkëpunim. Organi udhëheqës rregullisht përcjell harxhimet buxhetore me qëllim që të fitoj kualitet për harxhimin e mjeteve financiare. Të hyrat publike realizohen me anë të komisionit sipas ligjit për të hyra publike dhe rregullisht dorëzojnë raport deri te këshilli për të hyrat publike në formë elektronike për aktivitetet e realizuara.

Në bazë të analizës së kryer për këtë fushë vlen:

Anët e forta jetike:

- Arsimtarët çdoherë marrin pjesë në seminare për zhvillim profesional.
- Ndërrimi i përvojave në mes kuadrit arsimor.
- Shfrytëzimi maksimal i mjeteve didaktive që i ka shkolla , si dhe literatura profesionale dhe materiali harxhues.
- Kuadër profesional i përshtatshëm.
- Rregullshmëria e të punësuarve në punë në kohë të caktuar.
- Ndjekja e nevojave për zhvillim profesional të të punësuarve nga ana e drejtorit dhe organizim i ligjeratave dhe seminareve.
- Bashkëpunimi i mirë me qeverisjen lokale

Dobësitë:

- Mospasja e mësimit kabinetik
- Mospasja e mjeteve ndihmëse metodiko-didaktike
- Mospasja e sallës për edukatë fizike
- Mungesa e furnizimit më të mirë të bibliotekës me lektyra shkollore.

Mundësitë:

- Përkrahja nga qeverisja lokale , biznes sektori , gurbetqarët dhe qeveria

Rreziqet:

- Dinamika e organizimit të seminareve nga BZHA dhe MASH dhe akreditimi i institucioneve të ndryshme për realizimin e seminareve
- Mungesa e përkrahjes financiare për realizimin e disa korigjimeve nga infrastruktura.

Aktivitetet e ardhëshme nga kjo fushë që mund të kyçen në programën për zhvillim të shkollës

- Furnizimi i shkollës me mjete bashkëkohore metodito-didaktike
- Përmirësimi i hapsirave shkollore , gjegjësisht kabineteve
- Rregullimi i korridoreve të shkollës , njësoj si klasat.
- Sigurimi i literaturës profesionale për arsimtarët
- Sigurimi nga ana e MASH-it për furnizimin me laptop më modern për arsimtarët.
- Furnizimi me projektorë në secilën klasë.
- Ndërtimi i sallës së edukatës fizike

7. Udhëheqja, krijimi i politikave

Këshilli i shkollës është konstituar në bazë të rregullativave ligjore dhe statutit të shkollës. Mbledhjet që realizohen nga këshilli i shkollës janë të rregullta , me rend dite i menduar që më parë. Vendimet që i merr , kanë qasje të gjithë subjektet e interesuara të shkollës.Organi udhëheqës me sukses i koordinon dhe i bashkon të gjithë aktivitetet dhe nevojat e gjithë anëve të kyçura në punën e shkollës.

Organi udhëheqës përherë nxit , zhvillon dhe ndjek punën ekipore. Sjell vendime të drejta dhe të përgjegjshme dhe ka marrëdhënie profesionale kundrejt punës, e cila bazohet në aftësitë më të reja dhe ka aftësi që të delegon kompetenca , të komunikojë me nxënësit , të punësuarit dhe prindërit. Inicon dhe në mënyrë të suksesshme realizon ndryshime në punën e shkollës dhe në qendër të punës së tij vendoj të arriturat e nxënësve dhe lufton për përmirësimin e imazhit të shkollës.

Në mënyrë të suksesshme dhe produktive krijon partneritet me prefektin , shqorërinë lokale , sektorin joqeveritar dhe institucione tjera të cilët janë të lidhur për punën në shkollë. Qëllimet e shkollës janë në përputhshmëri me qëllimet e shtetit dhe me politikën arsimore lokale..

Këto bashkëpunime janë të qarta dhe janë të drejtuara nga zhvillimi i kualitetit të mësimit dhe përmirësimit të të arriturave të nxënësve.Shkolla që në mënyrë permanente mban mbledhje me këshillat e prindërve dhe këshillat e arsimtarëve i njeh të gjitha subjektet e interesuara për realizimin e qëllimeve të vendosura duke marrë parasysh edhe propozimet e tyre.

Në bazë të analizës së kryer për këtë fushë vlen:

Anët e forta jetike:

- Organi udhëheqës sjell vendime të përgjegjshme dhe me sukses udhëheq me ndryshimet në sistemin arsimor.
- Puna e këshillit është e definuar me **rregullore për punë**.
- Drejtori i shkollës brengoset për organizimin gjithëpërfshirës dhe realizimin e punës edukativo-arsimore në shkollë.
- Drejtori ka marrëdhënie profesionale ndaj punës që bazohet me njohje dhe aftësi më të reja për punë ekipore.
- Në shkollë egziston plan për përcjellje , evaulim dhe realizimin të aktiviteteve.
- Udhëheqësia e shkollës bazuar në mundësitë materiale i përkrah nxënësit dhe arsimtarët në të arriturat e tyre , i lëvdron , shpërblen dhe kujdeset për shëndetin e tyre.
- Organi udhëheqës inicon ndryshimet pozitive në punën e shkollës.
- Në kohë pregadit dhe dorëzon programën vjetore dhe raportin për punën në shkollë.
- Bashkëpunim ndërkomunal "Bashkimi" - Gostivar.
- Punë ekipore me kyçjen e të punësuarve në procesin e zhvillimit , planifikimit dhe sigurmi i

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019

kualitetit.

- Përkrahja e zhvillimit profesional të të punësuarve.
- Këshilli i shkollës në mënyrë transparente ka krijuar marrëdhënie partneriale me organin udhëheqës dhe strukturat tjera arsimore.

Mundësitë:

- Përkrahje nga qeverisja lokale
- Në mënyrë më të detajuar , informimi i arsimtarëve me vendimet e këshillit të shkollës si dhe mundësia për pjesëmarrje dhe ndikim në marrjen e vendimeve

Rreziqet:

- Dinamika e organizimit të seminareve nga BZHA dhe MASH dhe akreditimi i institucioneve për këtë qëllim.
- Mungesa e përkrahjes financiare për realizimin e investimeve infrastrukturore në shkollë

Mangësitë:

- Bashkëpunimi vertikal me aktivet profesionale
- Bashkëpunimi me shkollat e mesme në drejtim të informimit më real për të arriturat e nxënësve
- Mospasja e mjeteve për renovim të mësimit kabinetik.

Aktivitetet e ardhëshme nga kjo fushë që mund të kyçen në programin për zhvillim të shkollës

- Mobilizim i nxënësve në procesin e marrjes së vendimeve
- Kyçja më e madhe e prindërve në punën e shkollës
- Sjellja e rregullores për stimulim të arsimtarëve dhe nxënësve
- Përmirësimi i kushteve për mësimit kabinetik

8.Integrimi ndëretnik dhe zgjedhja e konflikteve

Kjo fushë bazohet në dhënien e pyetësorëve ku shumicën e rasteve përgjigjen të tre grupe të interesuara si arsimtarët, prindërit dhe nxënësit.Nga këto pyetësor duhet të shihet gjendja e shkollës në pikëpamje të integrimit ndëretnik si perceptohet aktualiteti dhe poashtu si dëshirojmë të duket ky perceptim.Pyetësorët për shkollën tonë, duke marrë parasysh situatën që është kjo shkollë,gjegjësisht shkollë njëgjuhëshe pa përfaqësim të nxënësve të përkatësisë tjetër etnike.

Pohimet e pyetësorit janë grupuar në katër kategori të përkufizuara sipas aktiviteteve për ndryshim, që duhet të ndodhin nëpër shkolla në drejtim të përmirësimit të integrimit ndëretnik përmes arsimit edhe atë:

1. Aktiviteti i nxënësve në shkollë
2. Aktiviteti i arsimtarëve në shkollë
3. Atmosfera dhe ambienti në shkollë
4. Bashkëpunimi me prindërit/komunën

Në këtë aktivitet morrën pjesë 25 arsimtarë që është 90% i grupit të përgjithshëm, 30 prindër dhe 60 nxënës, sipas parimit të përmendur më lartë.

8.1.Interpretimi i rezultateve

Pyetësorët pasi janë plotësuar, gjendet mesatarja nga katër fushat si dhe në tre grupet e interesura që do të na nevojiten për tu krahasuar, si në tabelën më poshtë.


Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë
Gostivar viti 2018 - 2019

Gjendja aktuale			Dimensione përshkrimi (TREGUES)	Gjendja e dëshiruar		
ARSIMTARË	NXËNËS	PRINDËR		ARSIMTARË	NXËNËS	PRINDËR
2,53	2,66	2,85	Aktivitetet e nxënësve në shkollë	2,55	2,67	2,87
2,56	2,63	2,76	1	2,56	2,65	2,76
2,52	2,63	2,76	2	2,56	2,65	2,80
2,52	2,65	2,83	3	2,56	2,63	2,83
2,48	2,66	2,76	4	2,52	2,66	2,80
2,60	2,68	2,86	5	2,60	2,68	2,90
2,44	2,69	2,86	6	2,52	2,63	2,90
2,56	2,71	2,90	7	2,56	2,71	2,90
		2,90	8			2,93
		2,93	9			2,93
2,56	2,66	2,90	10	2,56	2,71	2,90
2,48	2,70		11	2,52	2,70	
2,60	2,63		12	2,60	2,65	
2,56	2,66		13	2,56	2,66	
2,48	2,70		14	2,52	2,71	
2,55	2,67	2,83	Aktivitetet e arsimtarëve në shkollë	2,56	2,68	2,84
2,60	2,65	2,83	15	2,60	2,66	2,83
2,56	2,71	2,80	16	2,56	2,71	2,83
2,56	2,70	2,90	17	2,56	2,71	2,93
2,48	2,66	2,76	18	2,52	2,66	2,76
2,56	2,70	2,80	19	2,56	2,70	2,80
2,60	2,65	2,90	20	2,60	2,65	2,90
2,56	2,63	2,90	21	2,56	2,65	2,90
2,56	2,66	2,80	22	2,56	2,66	2,80
2,52	2,70	2,81	23	2,56	2,71	2,85
2,53	2,68	2,87	Atmosfera dhe ambienti në shkollë	2,55	2,69	2,88
2,52	2,66	2,86	24	2,52	2,66	2,86
2,48	2,68	2,86	25	2,52	2,68	2,90
2,44	2,71	2,90	26	2,48	2,71	2,90
2,60	2,70	2,93	27	2,60	2,71	2,93
2,64	2,66	2,81	28	2,64	2,71	2,86
2,52	2,70	2,86	29	2,56	2,70	2,86
2,53	2,68	2,87	Bashkëpunim me prind/komunë	2,55	2,69	2,88
2,56	2,71	2,80	30	2,56	2,71	2,83
2,48	2,70	2,76	31	2,52	2,71	2,76
2,52	2,66	2,76	32	2,52	2,71	2,80
2,56	2,68	2,80	33	2,56	2,71	2,82
		2,83	34			2,83
2,60	2,70	2,90	35	2,60	2,71	2,90
2,56	2,63	2,86	36	2,56	2,63	2,86
2,52			37	2,56		
2,54	2,67	2,84	Gjithsej nëpër fusha	2,55	2,68	2,85

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019

Nga të dhënat e tabelës nr.1 mund të paraqesim grafikun numër 1 ku paraqiten krahasimet ndërmjet përqindjeve hipotetike mestare për gjendjen aktuale, të dhëna nga arsimtarët, nxënësot dhe prindërit për të gjithë kategoritë e treguesve.




Grafiku nr.1

Nuk është konstatuar dallim i madh ndërmjet asaj se si e shohin arsimtarët, nxënësit dhe prindërit gjendjen aktuale në shkollë, gjegjësisht vlera mesatare nuk është më e madhe se 1,5 deri 2,5, pra në shumicën e rasteve dallimi është diku rreth 0,1 deri 0,3 si në fushën aktiviteti i nxënësve në shkollë, aktivitetii arsimtarëve në shkollë, atmosfera dhe ambienti në shkollë poashtu edhe bashkëpunimi me prindërit/komunën, gjegjësisht përgjigja është ndërmjet është pak ashtu dhe është shumë ashtu.

Sa i përket paraqitjes së krahasimit ndërmjet vlerësimeve mesatare, të dhëna nga arsimtarët, nxënësit dhe prindërit në raport me treguesin e caktuar për vlerësimin e aktivitetit me nxënësit, mund ta shohim në grafikun nr.2.

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019




Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019

Sa i përket grafikut nr.2 dallimi i konstatuar ndërmjet perceptimeve të arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve në fushën e aktiviteteve me nxënës nuk përshkruhen dallime ndërmjet tri kategorive sa i përket këtij aktiviteti dhe dallimi është shumë i vogël dhe qarkullon prej 0,1 deri 0,5, pra është më i vogël se 1,5 dhe nuk ekzistojnë dallime mes tre subjekteve siç janë arsimtarët, nxënësit dhe prindërit.

Sa i përket paraqitjes së krahasimit ndërmjet vlerësimeve hipotetike mesaatare të dhëna nga arsimtarët për gjendjen aktuale dhe atë të dëshiruar siç e shohim në grafikun nr.3



Grafiku nr.3

Për të gjithë kategoritë e treguesve, arsimtarët dëshirojnë përmirësimin e gjendjes aktuale që flet se arsimtarët janë plotësisht të vetëdijshëm për nevojat që shkolla të punojë në përmirësimin e integritit ndëretnik. Kur bëhet fjalë për krahasimet brengos që gjendja është ndër 3,5. Megjithatë do të merret parasysh se gjendja e perceptuar e treguesit është shumë më e rrezikuar sepse dallimi ndërmjet asaj se si është dhe si duhet të jetë e dëshiruar është ndërmjet 2,5 dhe 3,5 dhe është shumë e vogël.

Anët e forta të shkollës dhe prioritetet e vendosura në programën për zhvillim janë:

- Në shkollë do të llogaritet për të drejtat e fëmijëve dhe kyçjen e tyre aktive në jetën dhe punën e shkollës.
- Kuadri arsimor në hap me modernizimin e arsimit ku do të zmadhohet kreativiteti i procesit arsimor.
- Bashkëpunimi shumë i mirë mes arsimtarëve, drejtorit dhe shërbimit profesional
- Organi udhëheqës inicon ndryshime në punën e shkollës
- Për të arriturat e nxënësve, prindërit do të informohen rregullisht në mes mbledhjeve prindërore, e-ditarit dhe do ti jepet rëndësi trekëndëshit pedagogjik arsimtar-nxënës-prindër.
- Realizimi në kohë dhe kualitativ i planprogrameve msimore.
- Pregaditja në kohë i planeve globale, tematike dhe procesuale.

Raport nga realizimi i vetevaulimit e shkollës fillore "Çajla" - fsh. Çajlë

Gostivar viti 2018 - 2019

- Punë ekipore në mes arsimtarëve
- Arsimtarët mbajnë evidencë për rregullshmërinë, sjelljen dhe të arriturat e nënësve në regjistrin e paraleles, e-ditarin dhe fletave evidentuese.
- Orientimi profesional i nxënësve së klasës së IX duke u sqaruar konkurset e hapura për regjistrim në shkollat e mesme.
- Klima pozitive për punë në shkollë.
- Motivimi permanent i nxënësve për të arritura më të mira.
- Rregullshmëria e të punësuarve në vendin e punës sipas rregullave.
- Bashkëpunimi i mirë me prefektin dhe qeverisjen lokale.
- Pregaditja e planit për punë për vitin e ardhshëm.
- Vazhdim i bashkëpunimit me shkollat në nivel lokal, regjional, mbarëkombëtar dhe ndërkombëtar.
- Pregaditja e portfolios për çdo nxënës.
- Marrëdhëniet e të punësuarve në shkollë të rregulluara me rendin shtëpiak dhe kodeksin e sjelljes.
- Pregaditja e eko - projektit.

Propozim masa dhe sugjerime për zhvillim për periudhën e ardhshme.

- Zhvillim permanent, profesional i kuadrit arsimor.
- Mbajtja e mësimin duke përdorur mjete metodiko-teknike bashkëkohore.
- Kujdes më i madh tek komponenta e edukimit tek nxënësit.
- Përdorimi i notimit formativ dhe sumativ tek nxënësit.
- Të nxitet vetënotimi tek nxënësit.
- Të sillen rregullore për stimulim të arsimtarëve dhe nxënësve.
- Të mobilizohen nxënësit në procesin e sjelljes së vendimeve.
- Të sigurohen laptopë të rinj për arsimtarët dhe nxënësit nga MASH.
- Të formohet ekip që do të promovojë dhe afirmojë shkollën në komunë dhe regjion.
- Të adaptohet hapsirë funksionale për prezentim të të gjithë aktiviteteteve në shkollë.
- Të bëhet çmos për të siguruar mjete për ndërtimin e sallës së edukatës fizike.
- Njohja e prindërve me rolin e shkollës në zhvillimin e fëmijëve.
- Të zhvillohet bashkëpunimi më i madh me shkollat në komunat tjera.
- Të zhvillohet bashkëpunim më i madh me prindërit e nxënësve që kanë sukses më të dobët
- Të inicohet ndërtimi i eko amfiteatrit në oborrin e shkollës
- Të mundësohet furnizimi i bibliotekës shkollore me tituj të rinj dhe lektyra shkollore.

Kryetari i këshillit të shkollës
Gjylneare Miftari

Fshati Çajlë

Drejtori
Hava Sadiku